



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria për Shërbime Publike

Datë/a 25.11.2024

Në mbështetje të të nenit 12, paragrafi 2 pika „d” të Ligjit nr. 03L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovë, nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komunë, Komuna e Vushtrrisë organizon:

KONSULTIM PUBLIK
PËR DRAFT – PLANIN E TRANSPORTIT LOKAL PUBLIK TË UDHËTARËVE 2024-2028

Drejtoria për Shërbime Publike e ka vënë për konsultim publik Draft-Planin e Transportit Lokal Publik të Udhëtarëve 2024-2028.

Konsultimi publik do të zgjasë nga data 25.11.2024 deri më 25.12.2024.

Prandaj njoftojmë qytetarët, operatorët e transportit, OJQ-të, shoqërinë civile dhe të gjithë të interesuarit, se me datën 09.12.2024 e (hënë) do të organizojmë konsultim publik në sallën e Kuvendit, në objektin e Komunës së Vushtrrisë me fillim nga ora 10:00.

Ju inkurajojmë që të merrni pjesë në takimin dhe mirëpresim propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet eventuale gjatë këtij konsultimi publik.

Po ashtu ju njoftojmë se propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e juaja mund ti dërgoni në adresën elektronike islam.latifi@rks-gov.net.

Për gjithë kontributin tuaj paraprakisht ju falënderojmë.



Drejtori i drejtorisë

Benjamin Shala
Benjamin Shala